



Prishtinë: 19.12.2008
Kodi i ZRRE-së: V_137_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe Nenit 4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
3. Kërkesën e KOSTT SH.A për derogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes, dhe obligimeve që dalin nga Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit të datës 31 tetor 2008,

në seancën e mbajtur më 19 dhjetor 2008 nxori këtë:

VENDIM

1. **I lejohet** KOSTT SH.A. derogimi në zbatimin e dispozitave të neneve të **Kodit të Rrjetit**, dispozitave të neneve të **Kodit të Matjes** dhe dispozitave që dalin nga **Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit** si në **Aneksin** e këtij vendimi.
2. Të gjitha dispozitat tjera të Kodit të Rrjetit dhe Kodit të Matjes dhe Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit do të mbesin në fuqi.
3. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis gjuhëve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
4. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh prej miratimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
5. Ky vendim hyn në fuqi datën e lëshimit ose datën e publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këtij vendimi i bashkëngjiten këto dokumente:

1. Shtojca 1 - Kërkesa e KOSTT-it për derogim;
2. Shtojca 2 - Nenet për derogim;
3. Shtojca 3 - Kërkesa e KOSTT-it për korrigjim të derogimit të një neni të Kodit të Matjes;
4. Shtojca 4 - Sqarime.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Dr. Nysret Avdiu, Anëtar